



**PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET**  
**2024 - 2027**

KOMUNA E FERIZAJT

# PËRMBAJTJA

BAZA LIGJORE PËR ZHVILLIMIN DHE ZBATIMIN E PLANEVE TË INTEGRITETIT NË KOSOVË .....	3
PËRKUFIZIMI I TERMAVE .....	4
1. KONCEPTI, OBJEKTIVI DHE QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT .....	5
1.1. Çfarë është një Plan Integriteti?.....	5
1.2. Objektivi i Planit të Integritetit .....	5
1.3. Qëllimi i Planit të Integritetit .....	6
1. PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT .....	6
3. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT .....	7
4. PROCESI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT NË INSTITUCION .....	7
4.1 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut .....	8
4.2. Prioriteti i rreziqeve.....	10
5. PËRGJEDHJA E MASAVE.....	10
6. AFATI PËR ZBATIMIN E MASËS.....	11
7. STRUKTURA E PLANIT TË INTEGRITETIT .....	11
8. MIRATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT .....	12
9. PERSONI PËRGJEGJËS PËR RAPORTIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT 12	
10. RAPORTIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....	13
11. RISHIKIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT .....	14
12. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E PLANIT TË INTEGRITETIT .....	14
13. PJESA PËRFUNDIMTARE .....	14
SHTOJCA NR.1 MATRICA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT .....	15
SHTOJCA NR. 2 –VENDIMI PËR EMËRIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT .....	19
SHTOJCA NR.3 – PROGRAMI I HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT ..	21
SHTOJCA NR. 4 –PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT .....	23
SHTOJCA NR. 5 – NJOFTIM PËR PUNONJËSIT .....	25
SHTOJCA NR. 6– VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT ...Error! Bookmark not defined.	

## **BAZA LIGJORE PËR ZHVILLIMIN DHE ZBATIMIN E PLANEVE TË INTEGRITETIT NË KOSOVË**

Ligji nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit (tutje: Ligji), obligon Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit (tutje: APK) për nxjerrjen e Metodologjisë uniforme dhe udhëzimet përpilimin dhe zbatimin e Planeve të Integritetit.

Neni 25 i Ligjit obligon organet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale të Kosovës, të miratojnë planet e integritetit gjashtë (6) muaj pas miratimit të Metodologjisë së Planeve të Integritetit nga Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit. Pas miratimit të Planit të Integritetit, institucionet kanë afat 30 ditë për ta dorëzuar në Agjenci.

Sipas ligjit, Planet e Integritetit të institacioneve të përmendura në nenin 25 duhet të përbajnë elementet e mëposhtme:

- Një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korruptionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- Informacion përfushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- Llojet e rreziqeve të korruptionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- Masat ekzistuese të kontrollit;
- Masat parandaluese përvogëlimin e rrezikut të korruptionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet përzbatimin e tyre;
- Informacion përfundimor për personin përgjegjës përmes menaxhimin e hartimit dhe zbatimit të Planit të Integritetit;
- Të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë përfundimor të Planit të Integritetit;

## PËRKUFIZIMI I TERMAVE

**Integritet:** ndershmëri individuale, sjellje në përputhje me vlerat dhe parimet morale, integritetin institucional, përputhshmëri dhe qëndrueshmëri në veprime.

*“Integriteti është parimi i të vepruarit vazhdimisht në përputhje me vlerat etike dhe profesionale”.*

**Rreziku në kontekstin e Planit të Integritetit:** mundësia e shfaqjes së dëmit për shkak të ngjarjes së tashme apo të ardhme, e cila rrezikon integritetin e një institucioni, d.m.th. ndikim në shfaqjen e korruptionit, praktika etike dhe profesionale të papranueshme dhe parregullsi të tjera.

**Ndikimi i rrezikut:** vlera e dëmit për të mirën ose vlerën publike të mbrojtur (ndikimi i rrezikut mund të jetë i ulët, i mesëm ose i lartë).

**Probabiliteti-mundësia e rrezikut:** pasoja e dëmit të shkaktuar ndaj një të mire ose vlere publike të mbrojtur (rreziku mund të jetë i ulët, i mesëm ose i lartë).

**Vlerësimi i rrezikut:** vlerësimi i gjendjes aktuale të ekspozimit të një institucioni ndaj një rreziku specifik në një fushë të caktuar, të një intensiteti të ulët, mesatar ose të lartë, dhe rezulton nga vlerësimi i ndikimit të rrezikut dhe probabiliteti i rrezikut.

**Masa aktuale e menaxhimit të rrezikut:** masë eventuale e aplikuar nga një institucion, e cila shërben për të reduktuar rreziqet e korruptionit në një fushë të caktuar.

**Masa e përmirësimit:** masë e cila pas vlerësimit të masave të menaxhimit aktual të rrezikut, mund të reduktojë rrezikun e korruptionit në një fushë/proces të caktuar.

**Aktiviteti:** veprimet që duhen ndërmarrë për zbatimin e masës së përmirësimit.

**Fusha:** një fushë kyçë në funksionimin e një institucioni d.m.th., në përbushjen e mandatit të tij, e cila për shkak të natyrës mund të jetë rrezik korupsioni.

**Procesi:** një grup aktivitetesh të ndërlidhura të nevojshme për funksionimin brenda një fushe, p.sh. kompetenca, ndërsa procesi është një term më specifik se fusha d.m.th., çdo fushë përbëhet nga një grup procesesh të lidhura (rreziku).

**Pyetësori:** është instrument kërkimor i dizajnuar për mbledhjen e informacioneve të nevojshme për arritjen e qëllimeve kërkimore të synuara.

## **1. KONCEPTI, OBJEKTIVI DHE QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

### **1.1. Çfarë është një Plan Integriteti?**

Plani i Integritetit është dokument i brendshëm tre (3) vjeçar, që përcakton vlerësimin e rrezikut të korruptionit dhe formave tjera që e cenojnë integritetin, si dhe masat parandaluese. Si i tillë, Plani shërben për identifikimin e rreziqeve, analizën dhe vlerësimin e rrezikut dhe specifikon masat, sipas rreziqeve për arritjen e objektivave të saj të integritetit, për të avancuar performancën e integritetit në sektorin e administratës publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit dhe vlerave e standardeve profesionale.

Plani i Integritetit duhet shqyrtuar në mënyrë periodike dhe të aktualizohet në pajtueshmëri me zhvillimet relevante normative, institucionale dhe procedurale.

### **1.2. Objktivi i Planit të Integritetit**

Objktivi i Planit të Integritetit është:

- Thjeshtimi ose eliminimi i procedurave të komplikuara dhe të panevojshme;
- Shmangja nga situatat e konfliktit të interesit;
- Mbikëqyrja dhe reduktimi i të drejtave diskrecionale të menaxherëve;
- Monitorimi i transparencës në punë;
- Vendosja e standardeve;
- Krijimi i një sistemi më efikas të kontrollit të brendshëm;
- Eliminimi i praktikave në mospërputhje me rregulloret;
- Krijimi i një kulture organizative llogaridhënëse;
- Sjellja etike e menaxherëve dhe punonjësve.

### 1.3 Qëllimi i Planit të Integritetit

Qëllimi i Planit të Integritetit është:

- Identifikimi i proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive;
- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion, që synon respektimin e kërkesave ligjore, procedurale dhe kuadrit të brendshëm normativ;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike në qeverisjen dhe në performancën e integritetit të sektorit publik;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit, përmes përmirësimit të kontrolleve operacionale në fushat e funksionimit të institucionit dhe proceset e punës me rrezik korruptioni;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion, me fokus në fushat me rrezik të lartë të cenimit të integritetit, duke synuar integrimin e këtij procesi në kulturën institucionale.

## 1. PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit përban fusha të cilat konsiderohen si më të ekspozuara ndaj rreziqeve të korrupcionit dhe formave të cenimit të integritetit. Në procesin e zhvillimit të një plani, fushat e identifikuara ndahen si në vijim:

a) **Fushat e përbashkëta** – përfshijnë fushat si në vijim:

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
- Burimet publike dhe Menaxhimi i Financave Publike;
- Siguria e teknologjisë së informacionit;

b) **Fushat specifike** i referohen fushëveprimit dhe kompetencave specifike të çdo

institucioni.

### 3. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i hartimit të planit të integritetit fillon me caktimin e koordinatorit dhe anëtarët e grupit të punës për zhvillimin e planit të integritetit, nga ana e drejtuesit/personit përgjegjës të institucionit.

Hartimi i Planit të Integritetit kalon nëpër disa faza:

- **Faza e parë:** Drejtuesi/personi përgjegjës i institucionit merr vendim për emërimin e një Koordinatori dhe Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga një numër i arsyeshëm anëtarësh, në varësi të kompleksitetit të institucionit ose numrit të punonjësve. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).
- **Faza e dytë:** Grupi punues përpilon pyetësorin gjithëpërfshirës, si dhe mund të realizoj intervista me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit. Mbi bazën e rezultatit të pyetësorit, përcaktohen fushat e rrezikut dhe identifikimi i rreziqeve.
- **Faza e tretë:** Grupi punues përdorë të dhënat e siguruara për t'i përpiluar tabelat e rrezikut dhe të adresojë cenueshmërinë e integritetit dhe propozon masat për përmirësim. Në fund, institucioni publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

### 4. PROCESI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT NË INSTITUCION

Institucioni nëpërmjet një procesi vetë-vlerësimi të strukturuar realizon:

- Identifikimin e rreziqeve** në proceset e punës, burimet njerëzore dhe organizimin institucional të ekspozuara ndaj cenimit të integritetit. Kjo fazë përfundon

me një listë gjithëpërfshirëse të rreziqeve që cenojnë veprimtarinë e institucionit.

b) **Vlerësimi i rreziqeve** përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme.

Përmes vlerësimit të rezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rezikut përcaktohet sipas matricës së rezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

**Figura 1.** Matrica e vlerësimit të rezikut

Pasoja / Ndikimi	Madhor	10								
		9								
		8								
	Mesatar	7								
		6								
		5								
		4								
		3								
	Vogël	2								
		1	2	3	4	5	6	7	8	9
Intensiteti i rezikut (gjasat X ndikimi)	Ulët			Mesatar			Lartë			
	Probabiliteti/Gjasat									

Intensiteti i rezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

#### 4.1 Vlerësimi i përgjithshëm i rezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rezikut të cenimit të integritetit vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

**Rreziku me intensitet të ulët** – mundësia e ndodhjes së cenimit të integritetit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit, (rreziku nuk u shfaq në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen).

**Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut** - Ndikimi për integritetin e institucionit është i parëndësishëm.

**Rreziku me intensitet të mesëm** – ndodhja e cenimit të integritetit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik, (rreziku është shfaqur në një numër rastesh në të kaluarën, kështu që probabiliteti i ndodhjes në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen është i moderuar).

**Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut** - Ndikimi i është i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

**Rreziku me intensitet të lartë** – cenimi i integritetit ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin, (rreziku është shfaqur shpesh në të kaluarën dhe ekziston një gjasë e madhe që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen).

**Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut** – Ndikimi është shumë i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

#### 4.2. Prioriteti i rreziqeve

Prioriteti i rrezikut nënkupton renditjen e rreziqeve të integritetit, duke filluar nga rreziqe më parësore që paraqesin ndikim thelbësor në integritetin e institucionit dhe që mund të rrezikojnë efektshmërinë dhe reputacionin e tij, deri te rreziqet e ulëta të cilat nuk mund të kenë nevojë për masa, por mjafton të monitorohen në mënyrë të vazdueshme.

Pas përcaktimit të mundësisë së ndodhjes se rreziqeve dhe pasojave të rreziqeve të ndodhura, vijohet me përcaktimin e nivelit të rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuara dhe të vlerësuara, sipas matricës së rrezikut (në figurën nr.1).

Renditja e rreziqeve bëhet sipas rëndësisë, dhe përfshin vlerësimin midis mundësisë së ndodhjes apo shfaqjes së një rreziku dhe ndikimit të tij në integritetin e institucionit.

### 5. PËRZGJEDHJA E MASAVE

Bazuar në rezultatet e identifikimit, vlerësimit dhe prioritetin e rrezikut, grapi punues zgjedh masat adekuate, për të arritur qëllimet si më poshtë:

- Forcimi i transparencës;
- Publikimi pro aktiv i informacionit në faqet e internetit;
- Zbatimi i obligimit ligjor për qasje në dokumente publike;
- Transparenca e vendimmarrjes;
- Transparenca në procesin e përdorimit të fondeve buxhetore;
- Eliminimi i ndikimit të jashtëm në punën e punonjësve;
- Mbrojtja e personelit që raporton korrupsionin, konfliktin e interesit, formave të tjera të paligjshme ose sjelljeve jo etike,
- Zbatimi i kodit të etikës;
- Regjistrimi i marries së dhuratave nga punonjësit;
- Masa të tjera për përmirësimin e integritetit.

## **6. AFATI PËR ZBATIMIN E MASËS**

Afatet për zbatimin e masave duhet të caktohen në përputhje me intensitetin e rreziqeve, ose në përputhje me faktin nëse rreziku është me intensitet të ulët, mesatar ose të lartë.

Afatet mund të caktohen në dy mënyra:

- a. Duke specifikuar një afat kohor konkret, si p.sh. miratimi i një akti të brendshëm,
- b. Duke zgjedhur një afat periodik, p.sh. përcaktimi i një periudhe kohore për arritjen/përbushjen e masës.

## **7. STRUKTURA E PLANIT TË INTEGRITETIT**

Struktura e Planit të Integritetit duhet të përbajë masa që ndikojnë në reduktimin e rrezikut të korruptionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit, gjatë proceseve të ndryshme të punës brenda institucionit, i përcaktuar me kolona përfutjen e të dhënave në lidhje me sa vijon:

- Fusha e rrezikut;
- Përshkrimi i rrezikut;
- Masat ekzistuese të kontrollit dhe efikasiteti i tyre në tejkalimin e rreziqeve;
- Rezultatet e vlerësimit të pasojës dhe probabiliteti i shfaqjes së rrezikut;
- Masat e parashikuara për eliminimin/zvogëlimin e rrezikut;
- Personin përgjegjës për zbatimin e masave;
- Afatin për zbatimin e masave.

## **8. MIRATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

Koordinatori/kryesuesi i grupit punues prezanton Planin e Integritetit Drejtuesit/Personit përgjegjës të institucionit me propozimin për miratim.

Pas shqyrtimit dhe adresimit të vërejtjeve eventuale, Drejtuesi/Personi përgjegjës i institucionit nënshkruan miratimin e Planit.

Drejtuesi/Personi përgjegjës i institucionit i informon punonjësit për miratimin e planit të integritetit.

Vendimi për miratim dhe Plani i Integritetit do t'i dorëzohet Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e miratimit.

## **9. PERSONI PËRGJEGJËS PËR RAPORTIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**

Personi përgjegjës për raportimin e zbatimit të planit të integritetit emërohet me vendim nga Drejtuesi/Personi përgjegjës i Institucionit. Vendimi për emërimin e personit përgjegjës, me detajet e nevojshme të kontaktit, do t'i dorëzohet Agjencisë, bashkë me vendimin për miratimin e Planit.

Të gjithë punonjësit janë të detyruar të informojnë personin përgjegjës për situatën, veprimet, masat për të cilat ata janë të angazhuar për veprim.

Të paktën një herë në vit, me kërkesë të titullarit, personi përgjegjës duhet të paraqesë një raport për zbatimin e planit të integritetit.

## **10. RAPORTIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**

Personi përgjegjës për zbatimin e Planit të Integriteti, i raporton Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit lidhur me zbatimin e Planit të Integritetit, çdo gjashtë (6) muaj.

Raportimi duhet bërë mbi zbatimin e masave në mënyrën si më poshtë:

1. Masa është zbatuar në kohën e duhur;
2. Masa është zbatuar pas afatit;
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike.

Për masat që nuk janë zbatuar, përgjigjet e mundshme do të jenë si më poshtë:

1. Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të procesit;
2. Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të institucionit;
3. Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore;
4. Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës së buxhetit;
5. Masa nuk është zbatuar për arsyе të tjera;
6. Masa nuk është zbatuar për shkak se ende nuk është arritur afati për zbatimin e masës.

Për ata që raportojnë për zbatimin e masave, është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet menaxhimit joadekuat të procesit dhe menaxhimit joadekuat të institucionit. Arsyja e parë e ngarkon përgjegjësinë mbi drejtuesit dhe/ose punonjësit në njësi organizative individuale të institucionit, të cilët, për çfarëdo arsyë, nuk kanë ndërmarrë veprimet e duhura për respektimin e masës. Arsyja tjetër tregon se moszbatimi i masës është përgjegjësi e një titullari të institucionit, i cili për çfarëdo arsyë nuk ka parashikuar që aktivitetet që çojnë në respektimin e masave të zbatohen plotësisht.

## **11. RISHIKIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

Plani i Integritetit mund të ndryshohet, në përputhje me nevojat, zhvillimin dhe interesat e institucionit. Rishikimi i Planit të Integritetit bëhet çdo vit, në përputhje me Ligjin, nen 25.5 duke marrë në konsideratë rezultatet e zbatimit të masave të propozuara për reduktimin e rrezikut. Pas rishikimit, masat që rezultuan në mënyrë të pamjaftueshme në praktikë largohen dhe vendosen masa të reja.

## **12. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E PLANIT TË INTEGRITETIT**

Agjencia për Parandalimin e Korruptionit ka mandatin ligjor për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planeve të integritetit dhe nga kontrolli i drejtpërdrejtë në Institucion mund të zhvilloj procedurën e hetimit administrativ të raporteve për zbatimin e planeve të integritetit që ai institucion do t'i dorëzojë Agjencisë dhe si rezultat mund do të japë opiniune/rekomandime për parandalimin e korruptionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit. Institucionet e parapara me ligj obligohen të përgatisin dhe paraqesin në Agjenci raportin vjetor për zbatimin e planit të integritetit për vitin paraprak 31 janar të vitit vijues. Agjencia përpilon raport vjetor për monitorimin e planeve të integritetit.

## **13. PJESA PËRFUNDIMTARE**

Institucionet do të miratojnë planet e integritetit në përputhje me këtë Metodologji brenda gjashtë muajsh nga data kur metodologjia publikohet ne Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Plani i miratuar i dorëzohet Agjencisë në formatin e kërkuar. Mënyra e detajuar e regjistrimit dhe dorëzimit të planit të integritetit dhe raportit për zbatimin e planit të integritetit në formë fizike/elektronike rregullohet me vendim/udhëzim të veçantë. Kjo Metodologji do të hyjë në fuqi në datën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Pjesë e kësaj Metodologjie do të jenë të gjitha shtojcat e bashkangjitura.

## SHTOJCA NR.1 MATRICA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Planit i Integritetit

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Regjistrimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut				
Fusha rrezikut	Njësiazyrt përgjegjës	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Zë dikimi Gjasat	Vlerësimi	Masat propozuara përvogëlimin/ eliminimin e reziqeve	e Kostoja e zbatimit të masës	Njësia/zyrtarri përgjegjës	Afati i realizimit	Nivel i përbushjes së masave
Drejtimi dhe menaxhimi	Kryetari i Komunes, Dreitoria e Administrat es dhe Drejtore perkatese	Mos ndarja e detyrave te sakta nga menaxhment i komunës.	Ligjet, aktet nenligjore dhe aktet komunale ne fuqi.	7	8	56	Hartimi i planit vjetor të ndarjes së përgjegjësive përzyrëtarët komunal.	Kryetari i Komunes, Dreitoria e Administrat es dhe Drejtore perkatese	K2 (tremujori i dyte i vittit), 2023	
		Mos plotësimi i vendeve vakante të punës.		5	9	45	Plani i detajuar i rekrutimit.	Kryetari i Komunes, Zyra e Personelit.	Tremujori i fundit i vittit 2023.	
		Mungesa e hapsirave fizike për rekrutim.		5	5	25	Krijimi i hapësirës fizike për rekrutim.	Kryetari i Komunes, Zyra e Personelit.	Viti 2023	
Politika e burimeve njerëzore,	Mungesa e sjelljes profesionale.	Respektimi i ligjeve pozitive në	4	6	24	Organizimi i trajimeve	Zyra e Personelit /	Në vazhdimësi	.	

Regjistrimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Fushat e veçanta të rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
<b>Sjellja etike dhe professionale e të punësuarve</b>	fuqi. Respektimi i ligjeve pozitive në fuqi.	2	7	14	në fushat përkatëse.			Burimet njerezore		
Komisioni jo- objektiv i rekrutimit								Kryetari i Komunes / Zyra e Personelit.	Viti 2023	
<b>Planifikimi dhe menaxhimi financiar</b>	Mos përfshirja e të gjitha njesive komunale në proseset e planifikimeve financiare	5	7	35	Përfshirja e te gjitha nësive, ne procesin e planifikimit buxhetor			ZKF		
Informimi dhe komunikimi me qytetaret	Zyria për informim Mos kthimi i përgjigjeve ne afatet kohore Mos- publikimi i raporteve në ëeb-faqe të komunës	5	6	30	Hartimi i planit për komunikim me qytetare.			Zyria për informim, dhe njësit përgjegjëse.	Viti 2023	
		5	5	25	Përcjellja e raporteve nga Drejtitoritë në afate kohore.			Zyria për informim, dhe njësit përgjegjëse.	Viti 2023	

Fusha e rezikut	Njësia/zyrtari përgjegjës	Përshkrimi i Rezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Zdikimi	Gjasat	rrezikut Vlerësimi i	Masat e propozuara përzogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Kostoja e zbatimit të masës	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati
Auditimi i brenshem	Zyra e Auditimit	Mos shqyrëtimi i lëndeve brenda afatit kohor.	Auditimi i lëndeve dhe dhënia e rekomandimeve objektive të auditorit	3	3	9	Mbikqyria e shtuar e auditoreve nga udheheqesi i drejtperdrejtë.	Kabinet i Kryetarit	Viti kalendarik	
			Rekomandi mi joadekuat i të gjitha rreziqeve në lëndë.	3	3	9	Mbikqyria e shtuar e auditoreve nga udheheqesi i drejtperdrejtë.	Kabinet i Kryetarit	Viti kalendarik	
	Dreitoria perkatese	Aprovimi i kerkesa jo ne harmoni me buxhetin e dreitorise.	Vlerësimi nga komisioni i perzgjedhur	3	6	18	Vlerësimi ne baze te peshes se lendet.	Dreitoria perkatese	Viti kalendarik	
Administrata komunale	Zyrtari i gjendjes civile	Dhënia e informacioneve konfidencial e	Ligjet aktet nenligjore, akt et komunale	3	5	15	Rritja e siguris, peryzretaret e gjendjes civile, te cilët lëshojnë	Dreitoria e Administrates.	Ne vazhdimës i.	

					certifikata etj.	
	Nderhyra zyrtare në punët e ispektoriatit.	Ligjet aktet nenligjore, aktet komunale	8	9	72	Raportimi i interferimeve tek përgjegjësit e lartë.
Inspektimet	Tejkalimi i kompetenca ve ne detyrën zyretare.	Respektimi i ligjit dhe detyrave te punës	5	5	25	Mbikqyrja nga udheheqesi i drejtperdrejt.
Subvencione t grandet dhe bursat	Drejtoria perkatese	Dhenja e subvencione ve & grandeve jashtë kritereve	3	4	12	Formimi i komisionit profesional, duke u bazuar ne kriterë.
Drejtoria perkatese	Përzgjedhja e përfituesve të bursave jashtë kritereve	Ligjet aktet nenligjore, aktet komunale	3	4	12	Formimi i komisionit profesional, duke u bazuar ne kriterë.

## **SHTOJCA NR. 2 –VENDIMI PËR EMËRIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT**

### **SHTOJCA NR. 2 –VENDIMI PËR EMËRIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT**



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>



KABINETI I KRYETARIT  
MUNICIPAL PRESIDENT  
PREDSEDDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002  
Info.ferizaj@rks-gov.net  
Adresa: „Dëshmorët e Kombit” p.n.

01 Nr. 97/22  
Datë: 22.03.2022

Në bazë të nenit 44 të Ligjit 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, si dhe nenit 66 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28. 06. 2013, Kryetari i Komunës me datën 22.03.2022 merr:

#### **V E N D I M**

##### **I. Formohet Grupi Punues për Hartimin e Planit të Integritetit me këtë përbërje:**

1. Besnik Berisha – Drejtor i Drejtoria së Administratës të Përgjithshme – Koordinator i Hartimit të Planit të Integritetit;
2. Naim Misini - Auditimi i Brendshëm - Anëtar
3. Butrint Shabani - Prokurimi Publik- Anëtar;
4. Ekrem Emini - Administrata Komunale - Anëtar;
5. Ismajl Kamberi - Drejtoria e Pronës Gjeodezisë dhe Kadastrit - Anëtar;
6. Bashkim Bytyçi - Drejtoria e Arsimit - Anëtar;
7. Emira Sallahu - Drejtoria e Shëndetësisë - Anëtare;
8. Xhelal Topalli - Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Anëtar;
9. Skender Baftiu - Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit - Anëtar;
10. Ahmet Ferizi - Inspektorati Komunal - Anëtar;
11. Pajtim Cakolli - Inspektorati i Ndërtimit - Anëtar;
12. Selim Marevei – Zyra për Integrime Evropiane - Anëtar;
13. Selvete Bajraktari - Drejtoria e Arsimit - Anëtar;
14. Ilir Begiri – Zyra e Prokurimit - Anëtar dhe
15. Nesret Ademi - Drejtoria e Administratës – Anëtar.

Grupi punues përbëhet nga përfaqësuesit të Drejtorive Komunale me ç' rast secili përfaqësues duhet të bëj parashikimet dhe vlerësimet e rrezikut në drejtorin përkatëse duke vlerësuar atë nga 1 deri në 100, këto të dhëna pastaj duhet të paraqiten në formë tabelore.

Ky plan do të shfrytëzohet nga Komuna e Ferizajt për periudhën 2022 – 2026.

Plani i integritetit është një mjet përvendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e ceneshmërisë së Komunës dhe eksposimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korruptionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

Koordinatori/ja i këtij plani raporton tek Kryetari i Komunës për zbatimin e planit.

I dorëzohet:

1. Anëtarëve të Komisionit:
2. Arkivit të Zyrës së Kryetarit.

Kryetar i Komunës  
*Ngjim Aliu*  
Ngjim Aliu

## **SHTOJCA NR.3 – PROGRAMI I HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**

**Institucioni:** Komuna e Ferizajt

**Personi përgjegjs:** Evlid Ibishi

**Anëtarët e Grupit Punues:**

1. Besnik Berisha
2. Naim Misini
3. Butrint Shabani
4. Ekrem Emini
5. Ismajl Kamberi
6. Bashkim Bytyçi
7. Ermira Sallahu
8. Xhelal Topalli
9. Skender Baftiu
10. Ahmet Ferizi
11. Pajtim Cakolli
12. Selim Marevci
13. Selvete Bajraktari
14. Ilir Beqiri
15. Nesret Ademi

**Data e miratimit:** 14.06.2023

**Data e fillimit:** 30.06.2023

### **Hapi 1**

Nr.	Fazat e hartimit	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Data e takimit	Afati
1	Faza përgatitore	Udhëheqësi me vendim emëron Grupin Punues	Udhëheqësi	22.03.2022	Vendim i menjëhershëm
2		Grupi Punues përgatit Planin e Integritetit dhe Programin e Zbatimit	Grupi Punues	10.05.2022	

<b>3</b>		Informimi i punëtorëve lidhur me Planin e Integritetit	Grupi Punues	05.08.2022 10.08.2022	Në takim dhe përmes anëtarëve tek punonjësit
----------	--	--	--------------	--------------------------	--

## Hapi 2

Nr.	Fazat e zhvillimit	Masa/Aktiviteti	Personi përgjegjës	Data e takimit	Afati
<b>1</b>	Shkalla e vlerësimit dhe përmirësimit të gjendjes aktuale të punës-vlerësimi i ekspozimit të rrezikut	Kompletimi i pyetësorit	Grupi Punues	23.11.2022	14 ditë
<b>2</b>		Zhvillimi i Planit të Integritetit	Grupi Punues	02.11.2022	
<b>3</b>		Informimi i punëtorëve lidhur me Planin e Integritetit	Grupi Punues dhe Udhëheqësi	12.05.2023	

## Hapi 3

Nr.	Fazat e zhvillimit	Masa/Aktiviteti	Personi përgjegjës	Data e takimit	Afati
<b>1</b>		Hartimi i raportit përfundimtar	Grupi Punues	07.06.2023  Shih raportin:  <a href="https://kk.rks.gov.net/ferizaj/ep-content/uploads/sites/3/1/2023/06/Raporti-perfundimtar-me-detaie-i-PI-shq.pdf">https://kk.rks.gov.net/ferizaj/ep-content/uploads/sites/3/1/2023/06/Raporti-perfundimtar-me-detaie-i-PI-shq.pdf</a>	
<b>2</b>		Emërimi i personit përgjegjës për zbatimin e Planit të Integritetit	Evlid Ibishi - Përgjegjës për zbatimin e Planit të Integritetit		

## **SHTOJCA NR. 4 –PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT**

### ***Procesverbal për Projekt-Planin e Integritetit 2023-2027***

*Me datën 12 maj 2023, është mbajtur konsultimi publik në sallën e Kuvendit të Komunës për Projekt-Planin e Integritetit 2023-2027*

*Në hapjen e këtij konsultimi Nënkyetari i Komunës së Ferizajt, Lulzim Aliu, ka thënë se thënë se në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe "Strategjinë Shtetërore Kundër Korruptionit", obligohen të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit.*

*Sipas tij Komuna e Ferizajt, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2023 -2027. Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e ceneshmërisë së Komunës dhe eksposzimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korruptionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.*

*Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet strategjike, të përcaktuara nga Strategjia e Kosovës Kundër Korruptionit dhe Plani i Veprimit Kundër Korruptionit 2021-2023, në të cilat parashihet roli kyç i komunave në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit.*

*Profesionalizmi, efikasiteti, efektshmëria, kultura organizative, llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët do të ndikojnë që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyç të sistemit tonë të menaxhimit.*

*Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe "Strategjinë Shtetërore Kundër Korruptionit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Ferizajt, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2022 - 2026.*

*Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e ceneshmërisë së Komunës dhe eksposzimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korruptionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.*

*Plani rithekson përkushtimin e Komunës së Ferizajt për të shtuar dhe fuqizuar kontrolllet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standarde profesionale.*

*Në këtë konsultim publik, kanë mare pjesë zyrtarë komunal, anëtarë të kuvendit komunal si dhe qytetarë të tjera.*

*Anëtarja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt Mimoza Pajaziti nga Partia Demokratike e Kosovës, në këtë konsultim ka thënë se kush do të merret me zbatimin e mëtutjeshëm të këtij plani.*

*Lulzim Aliu-Me këtë plan do të merren të gjithë duke filluar nga Kryetari i Komunës e deri tek zyrtarët të tjera.*

*Ky konsultim publik ka përfunduar në orën 11:00.*

***Procesmbajtëse***

*Shyhrete Topalli*

## **SHTOJCA NR. 5 – NJOFTIM PËR PUNONJËSIT**

Të nderuar,

Ju njoftojmë se Komuna e Ferizajt ka filluar hartimin e Planit të Integritetit, sipas Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë pér Parandalimin e Korruptionit (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*), Nenit 25 të Ligjit, lidhur me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale, për miratimin e Planeve të Integritetit. Prandaj në raport me obligimet tona brenda afateve të përcaktuara ligjore, për hartimin e planeve të integritetit, afati i fundit për hartimin e Planit të Integritetit është periudha prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të përcaktuara në këtë ligj.

Duke e marrë parasysh konceptin dhe qëllimin e hartimit të Planit të Integritetit, i cili është një dokument që paraqet rezultatin e vetëvlerësimit të institucionit, ekspozimit ndaj rreziqeve të shfaqjes dhe zhvillimit të korruptionit dhe parregullsive të tjera, krijimi i një mekanizmi të tillë do të sigurojë efikasitet dhe efektivitet në funksionimin e institucionit, rritje të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë, thjeshtim të procedurave të komplikuara, rritje të transparencës dhe llogaridhënie në vendimmarrje, kontrollin e kompetencave diskrecionale, forcim të etikës, eliminimin e praktikave joefikase dhe rregulloreve të pazbatueshme, duke ndërtuar kështu një sistem efikas të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

Hartimi i Planit të Integritetit do të kryhet në tre faza:

**Faza e parë** është faza përgatitore në të cilën drejtuesi i institucionit merr vendim për hartimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit dhe cakton një koordinator, anëtarë të Grupit të Punës dhe një person përgjegjës për zbatimin e planit të integritetit.

**Faza e dytë** ka të bëjë me vlerësimin e gjendjes aktuale në fushat e institucionit të ekspozuara ndaj rrezikut dhe zhvillimin e praktikave të papranueshme nga pikëpamja etike dhe profesionale, korruptive dhe parregullsive tjera. Faza e vlerësimit përfshin përcaktimin e ekzistencës së masave të duhura për eliminimin e rrezikut të korruptionit, duke përfshirë edhe punonjësit në institucion.

**Faza e tretë ose faza përfundimtare** është projektuar për të përcaktuar masat, afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e masave. Pas miratimit të Planit të Integritetit, titullari i institucionit cakton një person përgjegjës për zbatimin e tij. Personi përgjegjës monitoron procesin, efikasitetin dhe rezultatet e zbatimit të masave të propozuara për integritetin e institucionit.

Më 22.03.2022, filluam fazën e parë të hartimit të Planit të Integritetit, duke miratuar

vendimin për hartimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit dhe emërimin e anëtarëve të Grupit Punues. Anëtarët e emëruar të Grupit Punues janë:

1. Besnik Berisha
2. Naim Misini
3. Butrint Shabani
4. Ekrem Emini
5. Ismajl Kamberi
6. Bashkim Bytyçi
7. Ermira Sallahu
8. Xhelal Topalli
9. Skender Baftiu
10. Ahmet Ferizi
11. Pajtim Cakolli
12. Selim Marevci
13. Selvete Bajraktari
14. Ilir Beqiri
15. Nesret Ademi

Grupi Punues do të përgatisë një program për hartimin e Planit të Integritetit, do të informojë punonjësit për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e zhvillimit të Planit të Integritetit, si dhe vlerësimin e gjendjes aktuale të ekspozimit të rrezikut në fushat e funksionimit të institucioneve.

Në fazën e vlerësimit të ekspozimit të institucionit ndaj rreziqeve të shfaqjes dhe zhvillimit të korrupzionit dhe parregullsive të tjera, në rast të propozimit të masave dhe aktiviteteve të përshtatshme shtesë për reduktimin dhe eliminimin e rreziqeve të identikuara, koordinatori i Grupit Punues mund të përfshijë punonjës nga fushat e funksionimit të institucionit.

Në hartimin e Planit të Integritetit, është e rëndësishme të sigurohet pjesëmarrja e punonjësve përfshirë faktin se ata e njohin funksionimin e proceseve të punës që kryejnë dhe mund të vlerësojnë rreziqet në mënyrën më të mirë dhe propozojnë masat adekuate për parandalimin dhe eliminimin e tyre.

Gjatë fazës së dytë, punonjësit dhe zyrtarët do të plotësojnë një pyetësor anonim i cili do të përcaktohet më vonë.

(Ferizaj, 30.09.2024)

